



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-1740/26  
Kaçanik, 30.01.2026

Në bazë të nenit 11 dhe 12. 1 dhe 2(d) lidhur me nenin 17 Ligjit Nr. 03L-040- Për Vetëqeverisje Lokale Gazeta Zyrtare Nr.28/4 Qershor 2008), të nenit 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087-Për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare Nr. 31/15 Qershor 2008) si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e këtij ligji, Nr. 04/L- 111 të vitit 2012 dhe Ligjit Nr. 05/L -009 të vitit 2015, të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 60/01-1740/26 prej datës 19.01.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 30 janar 2026, mori këtë:

#### V E N D I M

#### PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARVE TË KRM “PASTËRTIA” SH.A-NJËSIA KAÇANIK

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” SH.A., përkatësisht për Njësinë në Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi, do t'i ketë 3 anëtarë : 1 (Një ) anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe 2 (Dy) anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi i Komunës.
2. Përbërja e komisionit komunale të aksionarëve, do të jetë:
  - 2.1 Ermir Luma anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës,
  - 2.2 Fatmir Bunjaku anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës,
  - 2.3 Arton Salihu anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, **shkarkohen automatikisht të gjithë anëtarët e mëparshëm të Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A. - Njësia në Kaçanik, pa nevojë të nxirret vendim i veçantë për shkarkim.**
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim do të njoftohen:** MAPL, Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohet KRM “Pastërtia” SH.A-Ferizaj dhe mekanizmat tjerë relevantë). Arkivo



Kryesuesi i Kuvendit  
Seladin Troni



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

## Zyra e Kryetarit

01-Nr. 60/01-1740/26

Kaçanik 19.01.2026

Në mbështetje të neneve 11, 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d) dhe 47 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 043/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009 si dhe duke pasur parasysh nenin 33 të Rregullores së Punës së Kuvendit, kryetari i komunës, jep këtë:

### PROPOZIM

Që Komiteti për Politikë dhe Financa , në mbledhjen e radhës më 19.01.2026 të shqyrton dhe aprovon duke e proceduar për procedura të mëtejme në Kuvend të Komunës, pikën e rendit të ditës:

### VENDIM

#### **Për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A – Njësia në Kaçanik**

**I.** Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” SH.A, përkatësisht për njësinë në Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi, do t'i ketë 3 anëtarë: 1 (një) anëtar i emëruar nga kryetari i komunës dhe dy anëtarë të tjerë të emëruar nga kuvendi i komunës.

**II.** Përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, do të jetë:

1. \_\_\_\_\_ dhe
2. \_\_\_\_\_ dhe
3. \_\_\_\_\_

**III.** Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës.

**IV.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, **shkarkohen automatikisht të gjithë anëtarët e mëparshëm të Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A. – Njësia në Kaçanik**, pa nevojë të nxirret vendim i veçantë për shkarkim.

**V.** Ky vendim hynë në fuqi pas aprovimit në kuvend.

**VI.** Me këtë vendim do të njoftohen: Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, KRM “Pastërtia” SH.A – Ferizaj dhe Arkiva.



**Sabedin VISHI**  
Kryetar i Komunës